

NEVOJA PËR FORCIM TË SUNDIMIT TË LIGJIT NË KOSOVË

Prishtinë, 31 Maj 2010



Instituti Ballkanik i Politikave (IPOL) ishte pjese e publikimit të deklaratës se përbashkët të organizatave jo-qeveritare për sundimin e ligjit në republikën e Kosovës. IPOL shpreh mbështetjen e fuqishme për angazhimin e Prokurorisë Speciale të Kosovës dhe EULEX-it për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar në Kosovë.

Përderisa përshëndesim angazhimin e Prokurorisë Speciale dhe EULEX që të hetojnë dyshimet për korrupsion, kërkohet dhe pritet që këto hetime të prodhojnë rezultate konkrete. Një zmbropsje nga iniciativa aktuale do të ishte një goditje shumë e dëmshme për Sundimin e Ligjit dhe sigurinë në Kosovë. Krimi i organizuar dhe

Korrupsioni po e pengojnë të ardhmen Evropiane të Kosovës dhe luftimi i këtyre fenomeneve nuk guxon të lihet në mëshirën e agjendave të politikës ditore dhe interesave personale.

Reagimet e udhëheqësve të Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës, si dhe të partisë më të madhe në vend, të bëra ditëve të fundit ndaj punës së organeve të drejtësisë, na bëjnë të shqetësohemi ngase lejojnë hapësirë për dyshime në përkushtimin e sinqertë të tyre në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Diskursi publik që Qeveria e vendit po ndërton ditëve të fundit duke prezantuar punën e prokurorisë si ndërhyrje në institucionet e shtetit përbën kërcënim për punën e pavarur të organeve të drejtësisë. Tendencat për të prezantuar punën e organeve të drejtësisë si të rrezikshme për stabilitetin e vendit janë një kërcënim tjetër serioz për forcimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

EULEX duhet të krijojë hapësirë për përfshirjen e Prokurorëve kosovarë si dhe të sigurojë se edhe pas përfundimit të Misionit EULEX, Prokuroria Kosovare do të jetë në gjendje që me sukses të ndjekë dhe luftojë krimin e organizuar dhe korrupsionin.

Në këtë kontekst pritet nga Prokurorët vendorë që të përfshihen më aktivisht në procesin e hetimeve, grumbullimit të provave e dëshmive si dhe në përgatitjen e aktakuzave. Procesi i filluar i hetimeve për korrupsion dhe krim të organizuar është hap shumë i rëndësishëm për ndërtimin e besueshmërisë së shoqërisë kosovare në sistemin e drejtësisë, që paraqet parakusht për funksionim të shtetit ligjor.

NGJARJET E ARDHSHME:

Tryezë e rumbullakët mbi konkurrencën dhe mbrojtjen e konsumatorit.

PUBLIKIMET TONA: EULEX: Në kërkim të identitetit (Raporti i vlerësimit të punës njëvjeçare të EULEX-it).

Analizë për ligjin e prokurimit publik

Reforma e pushtetit lokal dhe sistemi zgjedhor

PROJEKTET TONA:

Konkurrenca, prokurimi dhe mbrojtja e konsumatorit

Ndërtimi i komunave të reja

Raporti krahasues mbi Ballkanin Jugor